

Nr. Prot.029/B/19

VENDIMI Nr. 1343

Për

Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të draft 'Rregullores për Autorizime të Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare'

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1), nenit 7 paragrafi 2.1) dhe paragrafi 2.2), nenit 16 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 3.1), nenit 20, dhe nenit 21 dhe 22, të Ligjit Nr. 06/L-38, për Shërbime Postare, (tutje referuar si - Ligji) nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike dhe nenit 13 paragrafi 1 dhe 5 i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 36, të Bordit të mbajtur më datë; 18.03.2019, bazuar në shqyrtimin e materialeve dhe propozimi i i përgatitur nga Sektori i Shërbimeve Postare, unanimisht vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik i dokumentit '**Rregullorja për Autorizime të Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare'**;
- II. Procesi i Konsultimit Publik fillon më datë; **21 Mars** dhe përfundon më **5 Prill 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Faqe 1 nga 2

Qëllimi i kësaj Rregullore, është vendosja e rregullave, përcaktimi i procedurave dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve postare, në Republikën e Kosovës, nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', e që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.

Ligji, respektivisht neni 7 paragrafi 2 përcaktonë se Autoriteti: *harton dhe miraton rregulloret në zbatim të këtij Ligji.*

Neni 8 përcakton se; *'Autoriteti gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore, të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në tregun e shërbimeve postare, duhet të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesit, nëpërmjet konsultimit publik, sipas procedurave të përcaktuara nga Autoriteti'.*

Neni 21 paragrafi 2), i Ligjit përcakton se; *'Autoriteti me akt të veçantë miraton rregullat për dhënien e Autorizimit të përgjithshëm'.*

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e nxjerrjes së Vendimit.

Prishtinë, 21/03/2019.

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

**Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve (ndërmarrësve) të cilët ofrojnë shërbimeve postare;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Sektorit të Shërbimeve postare (SSHP),
- Arkivës së Autoritetit.